



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

REFERENCË:			
PËR/ZA/TO:	Ministrat Udhëheqësit e Organizatave buxhetore Zyrtarët për buxhet të organizatave buxhetore		
CC:	Milaim Aliu, u.d. Drejtor i Departamentit të Buxhetit, MF		
PËRMES/PREKO/THROUGH:			
NGA/OD/FROM:	Avdullah Hoti, Ministër i Financave		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Qarkorja Buxhetore 2016/02		
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	Lokacioni: Kucni: Extension:	Data: Datum: Date:	04.08.2015

Të nderuar Ministra,

Të nderuar Udhëheqës të Organizatave buxhetore

Bashkëngjitur me këtë letër, ju lutem gjeni Qarkoren Buxhetore 2016/02 për Ministrinë dhe Agjensionet e Rregullatoret e pavarur të Nivelit Qendrorë. Përmes kësaj qarkore ju njoftojmë për strukturën e shpenzimeve sipas kategorive ekonomike për vitin 2016 dhe parashikimet për vitet 2017-2018.

Kjo qarkore është nxjerrë në përputhje me kompetencat ligjore të Ministrisë së Financave sipas nenit 20 të LMFPP-së. Udhëzimet e dhëna në këtë qarkore janë në përputhje me kushtet e marrëveshjes së arritur në mes të Qeverisë së Kosovës me Fondin Monetar Ndërkombëtar (Letra e Qëllimit), ku përcaktohen niveli dhe struktura e të hyrave dhe shpenzimeve në kuadër të buxhetit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës. Këto kushte janë reflektuar në procesin e rishikimit të buxhetit për vitin 2015, planifikimin buxhetor për vitin 2016, dhe parashikimet afatmesme 2017-2018.

Përveç strukturës së shpenzimeve, kjo qarkore ofron edhe sqarime shtesë për procesin buxhetor, kalendarin buxhetor dhe po ashtu, janë ofruar udhëzime për përmirësimin e klasifikimit kodues buxhetor si parakusht për planifikim më të avansuar strategjik.

Ju lutemi t'ju përmbaheni udhëzimeve të dhëna në këtë qarkore në përgatitjen e propozim-buxhetit për organizatën e juaj.

Për informata të mëtejme apo asistencë lidhur me cilindo element të kësaj qarkore, ju lutem kontaktoni analistët buxhetorë në Departamentin e Buxhetit të Ministrisë së Financa.

Sinqerisht,

Avdullah Hoti
Ministër i Financave



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Zyra e Ministrit / Kancelarija Ministra / Cabinet of the Minister

Qarkorja buxhetore 2016/2

Të nderuar Ministra,
Të nderuar Udhëheqës dhe Zyrtar për buxhet,

Bashkangjitur me këtë letër, gjeni Qarkoren buxhetore 2016/2 për Organizatat buxhetore të Nivelit qendror. Nisur nga obligimi për zbatimin e nenit 20 të LMFPP, me datë 15 Maj 2015, Ju kam dërguar Qarkoren e parë buxhetore 2016/01, përmes së cilës kam dhënë udhëzimet e para për përgatitjen e Buxhetit të Kosovës për vitin 2016 dhe vlerësimet për vitet 2017-2018. Këtij dokumenti buxhetor i janë bashkangjitur kufijtë indikativ buxhetor dhe kalendari kohor i hartimit të buxhetit. Gjithashtu, në këtë qarkore është theksuar se mund të pasojnë qarkore shtesë sipas nevojës.

Ministria e Financave ka pranuar nga organizatat buxhetore kërkesat e para buxhetore sipas kufijve të dhënë në Sistemet SZHMB dhe PIP – it, si dhe një numër të konsideruar të kërkesave shtesë mbi kufijtë buxhetor.

I. Qëllimi

Nxjerrja e Qarkores së dytë buxhetore ka për qëllim fillimisht, avancimin e procesit të hartimit të buxhetit për vitin 2016 dhe vlerësimeve për vitet 2017-2018, përfshirjen e politikave të reja të Qeverisë pas lëshimit të qarkores së parë buxhetore. Udhëzimet e dhëna me këtë qarkore janë në përputhje me kushtet e marrëveshjes së arritur në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), ku përcaktohet niveli dhe struktura e të hyrave dhe shpenzimeve në kuadër të buxhetit të përgjithshëm të Republikës së Kosovës. Në këtë drejtim dorëzimet e dyta buxhetore duhet plotësuar me informata shtesë që tregojnë arsyeshmërinë e plotë të kërkesave tuaja dhe njëkohësisht do të merren në konsideratë edhe ndryshimet e mundshme që kanë mundur të paraqiten gjatë ekzekutimit të gjertanishëm të buxhetit për vitin 2015 e të cilat ndikojnë edhe në buxhetin e vitit 2016 dhe buxhetet e viteve vijuese.

Më lejoni të ju njoftoj se kufijtë e përgjithshëm të shpenzimeve të paraqitur me Qarkoren e dytë do të ndryshojnë nga kufijtë e dhënë me Qarkoren e parë buxhetore pasi pjesa makro-fiskale e

të hyrat buxhetore është ndikuar (ulur) dhe si rrjedhojë do të ketë ndryshime në shpenzimet operative që do të ndikojnë në nivelin e përgjithshëm të shpenzimeve buxhetore. Kjo nënkupton që Organizatat buxhetore për të planifikuar çfarëdo iniciative të re buxhetore, duhet të bëjnë shkurtime në programet ekzistuese.

Hartimi i Buxheti për vitin 2016 dhe vitet vijuese është vazhdimësi nga viti 2015 për zbatimin të rregullës fiskale me kufizimet e deficitit buxhetor në 2% të Bruto Produktit Vendor. Zbatimi i kësaj rregulle kushtëzon planifikim të matur të shpenzimeve publike duke përfshirë në shpenzime të përgjithshme edhe vlerën e huamarrjeve të jashtme për projekte specifike gjatë kësaj periudhe. Kjo kërkon që renditja e prioriteteve për financim të jetë shumë e kujdesshme dhe brenda kufijve të dhënë buxhetor.

Organizatat buxhetore duhet që të sillen brenda politikave të përgjithshme të Qeverisë, kjo nënkupton që struktura e shpenzimeve buxhetore brenda kategorive ekonomike duhet respektuar dhe se lëvizjet prej një kategorie ekonomike në një kategori tjetër ekonomike vështirë se do të mbështetën me qëllim të ruajtjes së nivelit të investimeve kapitale e që ndikojnë në rritjen e përgjithshme të ekonomisë së Kosovës.

II. Kategoria e pagave e mëditjeve dhe kategoritë tjera ekonomike

Qarkorja e dytë buxhetore përmban kufijtë e fortë të cilët ndryshojnë nga kufijtë e dhënë me Qarkoren 01/2015, përfshirë kufijtë në paga dhe mëditje si dhe rritjet për përvojën e punës për çdo vit pune nga 0.5% të pagës bazë. Gjithashtu, në këtë kategori është përfshirë zbatimi i Marrëveshjes (Letra e Qëllimit) të nënshkruar në mes të Qeverisë së Kosovës dhe FMN-së, që ndikohen shpenzimet në disa zëra e të cilët e përbëjnë këtë kategori ekonomike.

Deri në aprovimin e Ligjit të ri për paga (që është në përgatitje), Organizatave buxhetore nuk ju lejohet të rrisin koeficientet e pagave apo nivelin e pagave në rastin kur ato janë fikse, shtimin e numrit të punëtorëve përtej kufizimeve buxhetore të dhëna në Ligjin e buxhetit si dhe krijimin e agjencive të reja pa disponueshmëri (zotim) të mjeteve nga buxheti i aprovuar.

Çdo mosrespektim i paragrafit të mësipërm nga organizata buxhetore/institucioni është hyrje në obligim pa mbulesë, shkelje e LMFPP dhe Ligjit vjetor të buxhetit. Në rast se paraqiten shkelje të tilla, atëherë përgjegjësia bie mbi zyrtarët të cilët marrin hapa të tillë për shkaktimin e mungesës së mjeteve buxhetore për të paguar shpenzimet e rregullta për paga gjatë vitit fiskal. Qeveria nuk do të ndaj mjete shtesë për mbulimin e këtyre obligimeve të krijuara pa mbulesë nga ana Organizatave buxhetore.

Duhet të respektohen plotësisht dispozitat ligjore me rastin e kërkesës për pagesë të punës pas orarit të rregullt të punës. Në shumë raste, këto shpenzime po e ngarkojnë edhe më tej kategorinë e pagave dhe mëditjeve. Ju sugjerojmë që gjatë vitit fiskal 2016 të keni parasysh dispozitat e Ligjit për Shërbyesit Civil që puna pas orarit të rregullt të kompensohet me ditë të lira.

Sa i përket strukturës së shpenzimeve, masa monetare për paga dhe mëditje do të përfshijë edhe kostot për përvojën e punës, për çdo vit pune nga 0.5% të pagës bazë. Planifikimi i punësimit të shërbyesve civil duhet të bëhet në përputhje me masën monetare në dispozicion për kategorinë ekonomike “*Paga dhe Mëditje*” për vitin 2016.

Bazuar në prioritetet e Qeverisë, në strukturën e shpenzimeve është ruajtur raporti në mes të shpenzimeve rrjedhëse dhe investimeve kapitale. Megjithatë, brenda shpenzimeve rrjedhëse, janë reduktuar lehtësisht ndarjet për kategorinë ekonomike mallra e shërbime me qëllim të

rritjes së ndarjeve për kategoritë tjera, për të përmbushur kërkesat e parashtruara nga Organizatat buxhetore për të mbuluar obligimet kontraktuale.

Në periudhën afatmesme 2016-2018, Qeveria do të ruajë nivelin e ndarjeve për investime kapitale sipas strukturës së vitit 2015. Për më shumë, kursimet e mundshme të shpenzimeve operative dhe të hyrave shtesë nga performanca më e mirë arkëtuese gjatë kësaj periudhe do të orientohen drejt ngritjes së nivelit të investimeve kapitale me karakter zhvillimor.

Gjatë procesit të planifikimit të investimeve kapitale, secila organizatë buxhetore duhet fillimisht të financojë me prioritet projektet në vazhdimësi, përfshirë edhe projektet me bashkëfinancim (me financim nga kredit apo me Donatorët potencial), dhe më pas projektet e reja sipas prioriteteve.

Qeveria do të vazhdojë të financojë investimet në infrastrukturën rrugore duke përfshirë Rrugën 6-Prishtinë-Shkup, si dhe rrugët me prioritet M2 Prishtinë – Mitrovicë dhe M9 Prishtinë – Pejë.

Përveç këtyre investimeve të drejtpërdrejta nga buxheti i rregullt, Qeveria brenda kësaj periudhe planifikon të financojë edhe disa projekte kapitale me rëndësi nacionale në fushën e arsimit, shëndetësisë, infrastrukturës, bujqësisë, etj. duke përdorur klauzolën/nenin e investimeve publike nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, sipas marrëveshjes me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Po ashtu do të vazhdojë mbështetje me subvencione dhe transfere për sektorin e bujqësisë, skemat pensionale dhe sociale (vazhdimi dhe implementimi në kohë i pagesave për veteranët e luftës dhe ish të përndjekurit politik), dhe për sektorin e shëndetësisë etj.

Gjithashtu mbështetje do t'i jepet forcimit të rendit dhe sigurisë (Reforma në sektorin e sigurisë) dhe krijimit të Forcave të Armatosura të Kosovës.

Analizat përkatëse në fazën e hartimit të buxhetit janë shumë të rëndësishme edhe për projektimin e buxhetit mbi bazën e performancës. Po ashtu këta indikatorë (indikatorët e performancës) ndihmojnë edhe procesin e raportimit dhe monitorimit të ekzekutimit të buxhetit.

III. Sistemet për planifikimin e buxhetit

Kërkohet nga Organizatat buxhetore që në mënyrë të detajuar, në sistemet operative (PIP dhe SZHMB-BDMS) të paraqesin kërkesat buxhetore duke respektuar kufirin e dhënë. Këto Sisteme nuk do të lejojnë në asnjë rast tejkalim të kufijve të lëshuar me qarkoren e dytë buxhetore.

Programi i Investimeve Publike (PIP)

Planifikimi i buxhetit për investime kapitale bëhet përmes sistemit të PIP-it . Prioritetet strategjike të Qeverisë, ashtu si janë paraqitur në “ Deklaratën e Prioriteteve Afatmesme të Qeverisë 2016-2018” brenda dokumentit të KASH-it, duhet të jenë bazë për përgatitjen e kërkesave buxhetore dhe identifikim të projekteve kapitale.

Të gjitha organizatat buxhetore duhet të arsyetojnë plotësisht kërkesat buxhetore për projektet e tyre përmes sistemit të PIP-it. Gjithashtu, të gjitha organizatat buxhetore njoftohen se në buxhetin e vitit 2016 do të bëhet adoptimi i tërësishëm i klasifikimit funksional për secilin projekt individual në fazën e planifikimit buxhetor.

Për të gjitha projektet kapitale individuale, zyrtarët - projekt menaxherët nga organizatat buxhetore - do duhet të përzgjedhin opsionin „*Funksioni*” që përkon me llojin e projektit.

Departamenti i Buxhetit do ofrojnë asistencë përmes një *Udhëzuesi për klasifikim të projekteve kapitale* për përzgjedhjen e funksionit si dhe përmes ndihmës së drejtpërdrejtë.

Adoptimi i këtij lloji të klasifikimit funksional, të aplikuar deri tani vetëm në fazën e raportimit financiar, mundëson planifikimin /ndarjen e buxhetit sipas funksioneve qeveritare (p.sh. arsim, ambientit, mbrojtje sociale, çështje ekonomike, administratë, etj.) dhe ofron infrastrukturën për zhvillimin e një procesi buxhetor të bazuar në prioritetet qeveritare.

Ju jeni të inkurajuar të përdorni *Udhëzuesin për klasifikim të projekteve kapitale* si dhe *manualin e PIP-it* që ofron udhëzime për procedurat e vlerësimit dhe planifikimit të projekteve, buxhetimin e fondeve kapitale dhe monitorimin e implementimit të projekteve që mund t'i gjeni të bashkangjitur në fund të ekranit të sistemit të PIP-it.

Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit (SZHMB-BDMS)

Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit është sistem financiar i cili merret me formulimin e buxhetit dhe planifikimin e shpenzimeve për të gjitha kategoritë ekonomike operative (numri i stafit dhe shpenzimet e tyre, pagat dhe mëditjet, mallrat dhe shërbimet, shpenzimet komunale, subvencionet dhe transferet si dhe kategoria e rezervave).

Në sistemin e SZHMB-ës kodet funksionale aplikohen që nga fillimi i planifikimit nëpër mes sistemit SZHMB-ës, kështu që organizata buxhetore përkundër sistemit PIP-it, nuk kanë nevojë të bëjnë zgjedhjen e kodit funksional për pjesën operative. Kodi funksional i cili kod shërben për raportim, caktohet automatikisht nga sistemi i SZHMB-ës pas çdo kërkesë të aprovuar për hapjen e një linje të re buxhetore.

Një manual përdorimi i SZHMB mund të merret direkt nga Ëeb- faqja ëëë.bdms-ks.org

IV. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator (BPGJ)

Sipas Ligjit për Barazi Gjimore Nr.05/L-020 (2015), institucionet e Kosovës janë përgjegjëse për "përfshirjen e buxhetimit gjinator në të gjitha fushat, si një instrument i nevojshëm për të garantuar që parimi i barazisë gjimore të respektohet në mbledhjen, shpërndarjen dhe caktimin e burimeve" (Neni 5.1.5.). Për këtë arsye, organizatat buxhetore duhet të bëjnë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në buxhetin vjetor për vitin 2016. Kjo do të kontribuon gjithashtu në rritjen e efektivitetit dhe transparencës së menaxhimit të financave publike.

Është e rekomanduar që çdo organizatë buxhetore të përdor tabelat e Shtojcës 3. dhe të integrojë ato si një shtojcë në buxhetin vjetor 2016, duke përdorur trendët e kaluara për të informuar shpenzimet e planifikuara.

Tabelat në Shtojcën 3. mund të përdoren për të informuar objektivat specifike, aktivitetet, dhe treguesit për rritjen e barazisë gjimore në sektorë të ndryshëm, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjimore. Ndoshta kjo nuk do të thotë një rritje në shpenzimet, por përdorim më efikas të burimeve ekzistuese dhe / ose shpërndarje më të barabartë të burimeve ekzistuese.

Nëse paraqiten pyetje lidhur me udhëzimet në këtë qarkore, organizatat buxhetore duhet të ndjehen të lira të konsultohen me analistët e tyre në kuadër të Departamentit të Buxhetit pranë Ministrisë së Financave (MF).

V. Dëgjimet buxhetore

Dëgjimet buxhetore do të mbahen nga data 31 gusht deri më 04 shtator 2015. Çdo Organizatë buxhetore duhet t'i përgjigjet me saktësi këtij orari. Orari i dëgjimeve buxhetore është dhënë në Shtojcën 2. Pjesëmarrës në këto dëgjime do të jenë zyrtarët më të lartë të Organizatës buxhetore/Agjencive, stafi i Ministrisë së Financave, Zyra e Kryeministrit, Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Kosovës dhe përfaqësues të Ministrisë për Integrim Evropian. Analistët e MF do të këshillohen me Organizatat buxhetore për të gjitha çështjet përkatëse para mbajtjes së dëgjimeve buxhetore. Ne presim që Organizatat buxhetore të ofrojnë një pasqyrë të përgjithshme të kërkesave të tyre për vitin 2016, procedurë e cila nuk do të zgjatë më shumë se 15 minuta, përfshirë këtu indikatorët e performacës sipas programeve dhe projekteve. Gjatë këtyre dëgjimeve, ne planifikojmë arritjen e marrëveshjes për shumën totale buxhetore të organizatës suaj për vitin 2016.

Është e rëndësishme që kërkesat buxhetore të jenë në harmoni të plotë me prioritetet strategjike të Qeverisë, ashtu siç janë paraqitur në "Deklaratën e prioritetëve strategjike për Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2016 – 2018 të paraqitura në KASH.

VI. Kërkesa Formale për Buxhet

Organizatat buxhetore, kërkesat e tyre duhet t'i dërgojnë më së largu deri më 21 Gusht 2015, në Departamentin e buxhetit në tri gjuhët zyrtare. Materialet dorëzohen në Arkivin e Ministrisë së Financave, kati i XII në kopje fizike si dhe elektronike Drejtorit të departamentit të buxhetit dhe analistëve përkatës.

Kërkesa për buxhet duhet të përfshijë:

- Letër kërkesa (shkresa përcjellëse) e firmosur/nënshkruar nga Sekretari i Përgjithshëm apo Kryeshefi i Agjencionit.
- Formularët PCF 2; 3 dhe 4,
- Tabela 3.1 e shtypur nga sistemi BDMS,
- Tabela 3.2 e shtypur nga sistemi PIP, si dhe
- Informata tjera të dobishme për aktivitetet që do të financohen nga kufiri i propozuar për financim në vitin 2016 dhe vlerësimeve për vitet 2017-2018.

Për informata të mëtejme apo asistencë lidhur me cilindo element të kësaj Qarkore, ju lutem kontaktoni analistin përkatës në Departamentin e Buxhetit të Ministrisë së Financa.

Me respekt,

Avdullah Hoti
Ministër

Bashkangjitur:

- Aneksi 1. Kufijtë për Buxhetin e viti 2016 dhe vlerësimet 2017-2018,
- Shtojca 2. Orari i dëgjimeve buxhetore.
- Shtojca 3. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinator (BPGJ)

Shtojca 3 – Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjikor (BPGJ)

Tabela 1. Numrat e punëtorëve në Organizaten Buxhetore përkatëse

[Emri iInstitucionit]

Viti	Numri total i stafit	Numri i stafit që janë gra	Numri i stafit që janë burra	Paga dhe medijtje /shuma per Gra	Paga dhe medijtje /shuma per Burra
2014					
2015					
2016					

Tabela 2. Planifikimi për vitin 2016 Nivelet e pagave në Organizaten Buxhetore

[Emri i Institucionit]

Nivelet e pagave	Numri total i stafit në nivele të pagave	Numri i burrave	Shuma e shpenzuar në burra	Numri i Grave	Shuma e shpenzuar në gra
201-400					
401-600					
600+					

Tabela 3. Numrat e përfituesve të subvencioneve apo edhe të shërbimeve ofruara nga organizata buxhetore të drejtorive përkatëse (ku është e aplikueshme)

Emri i Institucionit : Emri i Shërbimit/Subvencionit]

Viti	Buxheti total i shërbimit/su bvencionit të caktuar	Numri total i përfituesve	Numri i përfitueseve gra	Numri i përfituesve burra	Buxheti për gra	Buxheti për burra
2014						
2015						
2016						